



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.706/ 2 prot

Datë 06.04.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Splendent” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-22074-03-15-2022 me objekt: “Materiale mjekimi stomatologjike” me fond limit 3,000,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 28.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK
Rruga “Pavarsia”, Nd.1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder
Rruga :”Bujar Bishanaku”,Shkoder,Albania
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Splendent” SHPK
Elbasan, Lagjja Aqif Pasha, zona kadastrale 8524, pasuria nr.330/N.8 dhe 7/300N.9, kati 2.

Në datën 06.04.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.706 e operatorit ekonomik “Carpathia Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-22074-03-15-2022 me objekt: “Materiale mjekimi stomatologjike” me fond limit 3,000,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 28.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Splendent” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Carpathia Albania” SHPK në ankesën me nr.706 prot., datë 06.04.2022, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Splendent” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Splendent” SHPK të kritereve si më poshtë vijon:

1. 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Objekti i veprimtarisë duhet të jetë i pasqyruar në objektin e veprimtarisë të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në QKB, ku të shprehet qartësisht “MATERIALE MJEKIMI STOMATOLOGJIKE”

2. 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2018, 2019, 2020**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve të fundit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse;

3. 2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesim vertetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitet 2020-2021.

Deklarate nga operatori ekonomik pjesëmarrës se i ka shlyer të gjitha detyrimet vendore për këto vite.

4. 2.3 Kapaciteti teknik:

2. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plote).

5. 2.3 Kapaciteti teknik:

3.Operatori ekonomik duhet te paraqes deklarate per permbushjen e afatit te garancise minimumi 18 muaj nga data e levrimit te mallit.

6. 2.3 Kapaciteti teknik:

4.Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga kompania prodhuese për tregëtimin e artikujve të ofruar apo nga distributori i autorizuar nga prodhuesi ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin.

7. 2.3 Kapaciteti teknik:

5. Ofertuesi duhet te jete i pajisur autorizim për tregëtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, me perjashtim te listepageses e cila duhet te paraqitet elektronikisht.

8. 2.3 Kapaciteti teknik:

6. Shoqëria duhet te paraqes Certifikaten ISO 9001:2015 (Ekuivalente), lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

9. 2.3 Kapaciteti teknik:

7. Mallrat duhet te jene origjinal dhe te shoqeruara me certifikate cilesie dhe origjine ne momentin e dorezimit te tyre.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor

10. 2.3 Kapaciteti teknik:

8.Operatoret ekonomik duhet te paraqesim ne SPE Cerfikaten CE per te gjithë artikujt pjese perberese te preventivit.

11. 2.3 Kapaciteti teknik:

9. Kontrate e ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit prej **40% te fondit limit**, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit.Per kete te paraqiten:

-Per kontratat me Institucionet shtetere te paraqiten kontratat e lidhura te shoqëruara me vërtetime realizimi, dhe

-Furnizimet me subjekte private duhet të jenë të shoqëruara me fatura tatimore te shitjes te konfirmuara nga bleresi dhe shitesi ku te shenohen malli, shumat dhe sasite.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.04.2022

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro